

## **Departamenti i Monitorimit**

**Njësia e monitorimit të sistemit ligjor**

### **Komunitetet e ndryshme pranë sistemit të drejtësisë së Kosovës**

**Pasqyrë preliminare statistikore e dënimeve dhe rezultateve të  
gjkimeve në gjykatat e qarkut, komunale dhe për kundërvajtje**

**Dhjetor 2008**

## PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
1. HYRJE .....	4
1.1. Metodologjia .....	4
1.2. Interpretimi i të dhënave .....	6
2. SHKALLA E SHFAJËSIMIT/DËNIMIT .....	7
2.1. Gjykatat e Qarkut .....	8
2.2. Gjykatat komunale .....	8
2.3. Gjykatat për kundërvajtje .....	9
2.4. Analiza .....	9
3. LLOJET E DËNIMIT .....	10
3.1. Gjykatat e qarkut .....	10
3.2. Gjykatat komunale .....	11
3.3. Gjykatat për kundërvajtje .....	12
3.4. Analiza .....	13
4. DËNIMI MESATAR .....	14
4.1. Gjykatat e qarkut .....	14
4.2. Gjykatat komunale .....	15
4.3. Gjykatat për Kundërvajtje .....	16
4.4. Analizat .....	17
5. PËRKATËSIA E NJËJTË KUNDREJT PËRKATËSISË SË NDRYSHME ETNIKE TË GJYQ TARËVE .....	17
5.1 Shkalla e shfajësimit/dënimit .....	18
5.2. Lloji i dënimit .....	18
5.3 Dënimi mesatar .....	18
6. PËRFUNDIM .....	19

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet një pasqyrë preliminare statistikore të tri veprave penale (posedim i paautorizuar i armëve, vjedhje dhe prishje e qetësisë dhe rendit publik) të gjykuara nga gjykatat e qarkut, komunale dhe për kundërvajtje në Kosovë. Qëllimi i raportit është të krahasojë dënimet dhe rezultatet e gjykimeve në rastet ku përfshihen të pandehur shqiptarë të Kosovës ndaj komuniteteve tjera.

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka shqyrtuar më se 1,000 lëndë që përfshinin vepra të ngjashme, të kryera nga të pandehur të komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Pastaj, janë krahasuar rezultatet e gjykimeve dhe dënimet në rastet ku përfshihen shqiptarët e Kosovës kundrejt rasteve ku përfshihen serbët e Kosovës, romët, ashkallitë dhe egjiptianët<sup>1</sup> dhe boshnjakët e Kosovës.<sup>2</sup>

Krahasimet janë bazuar në tre indikatorë: norma e shfajësimit/dënimit apo detyrimit, lloji i dënimit dhe dënimi mesatar.

OSBE ka gjetur se rezultati mesatar në rastet ku përfshiheshin të pandehur shqiptarë të Kosovës nuk ka pasur dallim të madh nga ato në të cilat përfshiheshin të pandehur nga komunitetet tjera. Megjithatë, OSBE-ja ka vërejtur se disa indikatorë dallojnë varësisht nga përkatësia etnike e të pandehurit. Por këto dallime nuk janë konsistente në favor apo në dëm të një grupi specifik.

OSBE-ja nuk mund të përjashtojë mundësinë se faktorë të tjerë, siç janë pasuria ose statusi i të pandehurve, cilësia e avokatit mbrojtës apo nëse i pandehuri ka përsëritur veprat, kanë ndikuar në rezultat (në fajësinë apo pafajësinë, apo lartësinë e gjobës apo burgimit). Megjithatë, këto rezultate duhet të shihen si pikënisje për analiza më të thella statistikore.

Përfundimisht, të dhënat e analizuara nuk dëshmojnë ndonjë tendencë të qartë të gjyqësorit të Kosovës në favor të një komuniteti të veçantë në kuptim të shqiptimit të dënimeve.

---

<sup>1</sup> Romët, ashkallitë dhe egjiptianët janë komunitete të ndara në Kosovë. Megjithatë, për shkak të madhësisë së vogël të mostrave të komuniteteve individuale dhe problemeve të përbashkëta, OSBE-ja ka analizuar të dhënat e lidhura me këto tri komunitete si një.

<sup>2</sup> Të pandehurit e komuniteteve tjera përbëjnë përqindje të vogël, prandaj për shkak të mostrave të madhësisë së kufizuar OSBE-ja nuk i ka analizuar ato si komunitete të veçanta në këtë raport.

## 1. HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë nëse ka dallime në dënimet dhe rezultatet e gjykimeve në rastet ku përfshihen të pandehur shqiptarë të Kosovës dhe të pandehur nga komunitetet tjera.

Standardet ndërkombëtare plotësisht ndalojnë të gjitha format e “diskriminimit mbi çfarëdo baze, si për shembull mbi baza gjinore, racore, gjuhësore, fetare, bindjes politike apo bindjeve tjera, prejardhjes kombëtare apo sociale, asocimit me ndonjë pakicë kombëtare, të lindjes apo të statusi tjetër.”<sup>3</sup>

E drejta vendore në Kosovë përcakton standarde të ngjashme. Sipas Ligjit kundër diskriminimit të vitit 2004, “nuk ka kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, mbi bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statusi tjetër.”<sup>4</sup> Prandaj, përkatësia e një grupi specifik etnik nuk duhet të jetë faktor në vlerësimin e dënimit penal.

Raporti përmban një pasqyrë statistikore të ndëshkimeve të shqiptuara nga gjykatat e qarkut, komunale dhe ato për kundërvajtje në Kosovë, në lëndët që përfshijnë si të pandehur shqiptarë të Kosovës ashtu edhe joshqiptarë të Kosovës. Statistikat bazohen në informatat që OSBE-ja i ka siguruar nga punonjësit e gjykatave. Ato nuk përmbajnë fakte specifike për lëndë individuale, por në fakt synojnë identifikimin e trendeve të rëndomta.

### 1.1. Metodologjia

Analizimet e të dhënave janë të ndara në tri pjesë, duke pasqyruar tri nivelet e kompetencave të gjykatave të Kosovës: gjykatat e qarkut, gjykatat komunale dhe gjykatat për kundërvajtje.<sup>5</sup>

#### 1.1.1. Veprat

Për të krahasuar lëndët e ngjashme, OSBE-ja ka vlerësuar një vepër specifike për çdo gjykatë:<sup>6</sup>

- Pronësia, kontrollimi, posedimi apo përdorimi i paautorizuar i armëve (Armëmbajtja pa leje, neni 328(2) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës)<sup>7</sup> për gjykatat e qarkut;
- Vjedhja (neni 252(1) i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës) për gjykatat komunale; dhe

<sup>3</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14. Shih edhe nenin 26, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike: “Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë në mbrojtje të ligjit pa diskriminim.”

<sup>4</sup> Shih nenin 2(a), në Ligjin kundër diskriminimit, nr. 2004/3, 19 shkurt 2004, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32, 20 gusht 2004.

<sup>5</sup> Për më shumë informata mbi gjykatat për kundërvajtje shih Raportin e OSBE-së, *Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale: Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, Administrimi i drejtësisë në gjykatat për kundërvajtje, Procedurat penale për të miturit* (2006), faqet 19-22.

<sup>6</sup> OSBE-ja ka zgjedhur veprat që kanë ndodhur relativisht shpesh në Kosovë, me qëllim që të ketë një numër më të madh shembujsh të rasteve.

<sup>7</sup> Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003/25, *mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës*, 6 korrik 2003 (“Kodi i Përkohshëm Penal”).

- Prishja e rendit dhe qetësisë publike (neni 18 i Ligjit mbi rendin dhe qetësinë publike)<sup>8</sup> për gjykatat për kundërvajtje.

OSBE-ja ka shqyrtuar vetëm lëndët që përfshijnë të pandehur të cilët janë të akuzuar vetëm me njëri nga veprat e sipërpërmendura dhe në këtë mënyrë kanë përjashtuar lëndët ku i pandehuri është i akuzuar për vepra të shumëfishta. Veç kësaj, OSBE-ja ka shqyrtuar vetëm lëndët e lehta dhe si pasojë ka përjashtuar lëndët e vjedhjes së rëndë<sup>9</sup> dhe armëmbajtjes pa leje në rrethana rënduese<sup>10</sup> nga mostra e të dhënave.

Periodha e mbuluar është nga prilli 2004 (data e hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm Penal) deri në mars të vitit 2008.

Për të rritur besueshmërinë e të dhënave statistikore, OSBE-ja ka shqyrtuar një numër të madh të lëndëve (702 që përfshijnë shqiptarë të Kosovës dhe 355 që përfshijnë joshqiptarë të Kosovës, gjithsej 1057 lëndë). Mosfunksionimi i gjykatave në tri komuna veriore pas shkurtit të vitit 2008 e ka pamundësuar sigurimin e të dhënave nga gjykata komunale dhe ajo për kundërvajtje në Mitrovicë/Mitrovica, Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok. Kjo ka rezultuar në shumë më pak raste që përfshinin të pandehur joshqiptarë të Kosovës në gjykatat komunale dhe për kundërvajtje.<sup>11</sup>

### 1.1.2. Përkatësia etnike e të pandehurve

OSBE-ja ka shqyrtuar shembuj të rasteve të zakonshme dhe nuk ka para-zgjedhur raste bazuar në përkatësinë etnike të ndonjë të pandehuri të veçantë.

Siç është detajuar në Tabelën 1, OSBE ka analizuar rastet që përfshini veprat e pandehura penale të armëmbajtjes pa leje (gjykatat e qarkut), vjedhjes (gjykatat komunale) dhe prishjes së rendit dhe qetësisë publike (gjykatat për kundërvajtje):

**Tabela 1**

	Lëndët që përfshinin shqiptarë të Kosovës	Lëndët që përfshinin joshqiptarë të Kosovës
Gjykatat e qarkut (armëmbajtja pa leje)	126	110
Gjykatat komunale (vjedhje)	259	79
Gjykatat për kundërvajtje (prishja e rendit dhe qetësisë publike)	317	166
<b>GJITHSEJ</b>	<b>702</b>	<b>355</b>

Tabela në vijim përmbledh numrin e rasteve ku përfshihen të pandehurit shqiptarë të Kosovës dhe joshqiptarë të Kosovës, sipas përkatësisë etnike.

<sup>8</sup> Ligji mbi rendin dhe qetësinë publike, në Gazetën Zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nr. 13 i vitit 1981.

<sup>9</sup> Neni 253, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>10</sup> Neni 328(1) dhe 328(3), Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>11</sup> Të dhënat nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë janë siguruar para shkurtit të vitit 2008.

**Tabela 2**

	Gjykatat e qarkut (armëmbajtja pa leje)	Gjykatat komunale (vjedhje)	Gjykatat për kundërvajtje (prishja e qetësisë dhe rendit publik)
Serbë	78	37	97
Boshnjakë	14	23	24
Romë, ashkali, egjiptianë	10	14	38
Goranë	0	4	3
Turq	5	1	1
Malazezë	1	0	0
Kroatë	2	0	2
<b>GJITHSEJ</b>	<b>110</b>	<b>79</b>	<b>165</b>

Në rastet e analizuara nga OSBE, përqindja më e madhe e të pandehurve joshqiptarë të Kosovës është e përbërë nga serbët e Kosovës. Boshnjakët e Kosovës dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët, janë përkatësisht komunitetet e dyta dhe të treta për nga madhësia. Të pandehurit nga komunitetet tjera përbëjnë përqindje të vogla dhe për shkak të madhësisë së vogël të mostrës, OSBE-ja nuk i ka analizuar ato si komunitete të veçanta në këtë raport.

### 1.1.3. Treguesit

Bazuar në të dhënat e papërpunuara të grumbulluara në gjykata të ndryshme, OSBE-ja ka krahasuar lëndët e ngjashme që përfshinin të pandehur shqiptarë të Kosovës dhe joshqiptarë të Kosovës, në bazë të tre treguesve:

1. Shkalla e Dënimit/shfajësimit<sup>12</sup> apo detyrimit;
2. Lloji i dënimit (burgimi kundrejt gjobës monetare; dënime me kusht kundrejt dënimeve pa kusht); dhe
3. Dënimi mesatar (gjatësia e burgimit apo shuma e gjobës).

Veç kësaj, OSBE-ja ka krahasuar lëndët që përfshinin të pandehur shqiptarë të Kosovës me ato që përfshinin të pandehur nga tri komunitetet më të mëdha joshqiptare të Kosovës: serbë të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, dhe romë, ashkali dhe egjiptianë.

Në seksionin e fundit, OSBE-ja po-ashtu ka krahasuar edhe ndëshkimet në rastet ku i pandehuri dhe gjyqtari ishin të së njëjtës përkatësi etnike me rastet ku secili prej tyre ishte i përkatësisë tjetër etnike.<sup>13</sup>

## 1.2. Interpretimi i të dhënave

Përcaktimi nëse një person është fajtor apo i pafajshëm, vendimi mbi shqiptimin e dënimit dhe llogaritja e lartësisë së ndëshkimit mund të ndikohen nga shumë

<sup>12</sup> Për qëllime të këtij raporti, “shfajësimi” përfshinë çdo përfundim që nuk është dënim penal (p.sh. përfundimi i procedurave gjyqësore, hedhja poshtë e aktakuzës, apo qortimi gjyqësor).

<sup>13</sup> Ky krahasim ishte i mundshëm vetëm bazuar në të dhënat e mbledhura në gjykatat komunale. Të dhëna të pamjaftueshme kishte për gjykatat komunale dhe për kundërvajtje, ku shumica dërmuese e lëndëve (ndërmjet 95% dhe 99%) përfshinin gjyqtarë shqiptarë të Kosovës.

faktorë. Këtu përfshihen pesha e dëshmimeve të prezantuara nga ana e prokurorit, angazhimi i avokatit mbrojtës, se a ka gjyqtari tendencë t'i dënojë kryesisht më rëndë apo më lehtë, sasia e dënimit të shkaktuar nga i pandehuri dhe atë se a është i pandehuri recidivist.

Aktgjykimi përfundimtar në një gjykim kryesisht varet nga diskrecioni i gjyqtarit. Ligji përcakton parimet e përgjithshme për përcaktimin e llojit të dënimit që do të shqiptohet, si dhe llogaritjen e dënimit dhe përcakton nivelet brenda të cilëve mund të zgjedhë gjyqtari. Megjithatë, gjyqtari përfundimisht ka liri të gjerë veprimi në vendosjen e rezultatit të gjykimit si dhe llojit dhe masës së dënimit në çfarëdo rasti specifik. Gjyqtari nuk duhet të lejojë që përkatësia etnike e të pandehurit të ketë ndikim në vendimin e tij apo saj.

Prandaj, është e mundur që dy gjyqtarë të ndryshëm, të dy kryetarë paneli në raste që përfshijnë fakte identike, mund të shqiptojnë dënime të ndryshme. Ngjashëm, është e mundur që dy të pandehurit të cilët kanë kryer të njëjtën veprë penale (p.sh. vjedhja e një biçiklete) marrin dënime të ndryshme. Kjo mund të jetë për shkak të dallimeve të sjelljes së tyre në të kaluarën, pranimit të fajësisë, apo rrethanave të tyre personale familjare,<sup>14</sup>

Edhe nëse statistikat tregojnë dallime ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe joshqiptarëve të Kosovës të gjykuar për vepra të ngjashme, kjo nuk dëshmon domosdoshmërisht se gjyqtarët janë të anshëm ndaj një grupi të veçantë. Në fakt, të dhënat e papërpunuara që janë mbledhur nuk tregojnë arsye për këto dallime. Për shembull, dënimet mesatare më të lehta të pranuar nga një grup mund të nënkuptohet se të pandehurit e atij grupi mesatarisht kanë pasur mundësi të paguajnë avokatë më të shtrenjtë, apo mesatarisht kanë kryer vepra më pak serioze sesa grupi tjetër (p.sh. një grup mund të vjedhë kryesisht biçikleta, ndërsa grupi tjetër kryesisht vjedhë vetura).

OSBE ka tentuar të analizojë rastet që përfshinin llojllojshmëri të situatave faktike duke shqyrtuar më se 1,000 raste. Për shembull, mund të supozohet se brenda një mostre prej 100 rasteve të vjedhjes, disa do të përfshijnë mjete të shtrenjta e të tjera raste mjete jo të shtrenjta, disa mund të kenë përfaqësim të mirë e disa të tjerë përfaqësim të mangët ligjor

Raporti paraqet të dhënat e papërpunuara në formë të tabelave të përcjella me një tekst përshkrues.

## **2. SHKALLA E SHFAJËSIMIT/DËNIMIT**

Së pari, OSBE ka krahasuar rastet ku përfshiheshin të pandehurit nga komunitete të ndryshme bazuar në rezultatin e gjykimeve që do të thotë përqindjen e personave të dënuar kundrejt përqindjes së atyre të shpallur të pafajshëm.

Për qëllime të këtij raporti, OSBE-ja i ka ndarë lëndët në dy pjesë, në pjesën e dënimeve (ku gjykatat i kanë dënuar të pandehurit me gjobitje ose burgim), dhe atë të “të pafajshmëve”. Kategoria e “pafajshme” i përmban të gjitha rastet ku gjykimi nuk ka rezultuar me dënim (p.sh. i pandehuri është shfajësuar ose qortuar, aktakuza

<sup>14</sup> Shih nenin 64(1), Kodi i Përkohshëm Penal.

është hedhur poshtë, i pandehuri ka vdekur ose procedurat kanë përfunduar për shkak të mungesës së provave materiale).

## 2.1. Gjykatat e Qarkut

**Tabela 3**

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Të dënuar	118 (94%)	103 (94%)
Të pafajshëm	8 (6%)	7 (6%)

**Tabela 4**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
Të dënuar	13 (93%)	10 (100%)	73 (94%)	118 (94%)
Të pafajshëm	1 (7%)	0 (0%)	5 (6%)	8 (6%)

Të dhënat e mbledhura në gjykatat e qarkut, siç janë pasqyruar në Tabelën 4, tregojnë përqindje shumë të ngjashme të shfajësimeve (6-7%) dhe dënimeve (93-94%) për boshnjakët e Kosovës, serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës. Megjithatë, të gjitha rastet e ekzaminuara që përfshijnë romë, ashkali dhe egjiptianë, kanë rezultuar me dënim të të pandehurve.

## 2.2. Gjykatat komunale

**Tabela 5**

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Të dënuar	230 (89%)	60 (76%)
Të pafajshëm	29 (11%)	19 (24%)

Të dhënat e mbledhura në gjykatat komunale në Tabelën 5 tregojnë shkallë relativisht të krahasueshme të shfajësimeve/dënimeve për të pandehurit shqiptarë të Kosovës dhe të pandehurit joshqiptarë të Kosovës. Vlen të ceket se shkalla e pafajësisë është më shumë se e dyfishtë për joshqiptarët e Kosovës se sa për shqiptarët e Kosovës (24% vs. 11%).

**Tabela 6**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
Të dënuar	21 (91.3%)	9 (64%)	28 (76%)	230 (89%)
Të pafajshëm	2 (8.7%)	5 (36%)	9 (24%)	29 (11%)



Ndarja sipas përkatësisë etnike të të pandehurve në Tabelën 6 tregon disa dallime ndërmjet disa komuniteteve. Të pandehurit boshnjakë të Kosovës e kanë shkallën më të lartë të dënimeve (91%), përderisa më të ulëtën e kanë romët, ashkallitë dhe egjiptianët (64%). Të gjitha grupet kishin shkallë të pafajësisë nën 40%.

### 2.3. Gjykatat për kundërvajtje

**Tabela 7**

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Përgjegjës	290 (91%)	115 (69%)
Jo përgjegjës	27 (9%)	51 (31%)

Të dhënat e mbledhura nëpër gjykata për kundërvajtje, në tabelën 7 paraqesin përfundime mjaft të ndryshme ndërmjet gjykimeve për të pandehurit shqiptarë të Kosovës dhe ata joshqiptarë të Kosovës. Gjykatat kanë shpallur joshqiptarët e Kosovës jo-përgjegjës pothuajse katër herë më shpesh se sa shqiptarët e Kosovës (31% vs. 9%).

**Tabela 8**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
Përgjegjës	11 (46%)	29 (76%)	72 (74%)	290 (91%)
Jo përgjegjës	13 (54%)	9 (24%)	25 (26%)	27 (8%)

Ndarja sipas përkatësisë etnike të të pandehurve në Tabelën 8 tregon përqindjet e ndryshme të dukshme të shfajësimeve dhe dënimeve ndërmjet përkatësive etnike. Të pandehurit shqiptarë të Kosovës e kishin shkallën më të lartë e të qenit përgjegjës (mbi 91%), përderisa boshnjakët e Kosovës më të ulëtën (nën 46%). Serbët e Kosovës dhe romët, ashkallitë e egjiptianët kishin shkallë të krahasueshme të përgjegjësisë (rreth 75%).

### 2.4. Analiza

Të dhënat tregojnë shkallë më të lartë të pafajësisë për të pandehurit joshqiptarë të Kosovës në nivel të gjykatave komunale (ku gjyqtarët i shfajësuan të pandehurit joshqiptarë të Kosovës dy herë më shumë sesa të pandehurit shqiptarë të Kosovës), dhe në nivel të gjykatave për kundërvajtje (pothuajse katër herë më shumë). Siç është shënuar, si në gjykatat komunale ashtu edhe në gjykatat për kundërvajtje, pothuajse të gjithë të pandehurit joshqiptarë të Kosovës janë gjykuar nga gjyqtarët shqiptarë të Kosovës.<sup>15</sup> Në gjykatat e qarkut, shkalla e dënimit për dy grupet është përafërsisht identike.

<sup>15</sup> Siç është sqaruar më lartë (fusnota 13), në gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje, shumica dërmuese e rasteve (ndërmjet 95% dhe 99%) kishin përfshirë gjyqtarë shqiptarë. OSBE nuk ka pasur mundësi të mblidhte të dhëna prej pesë gjykatave me numër më të lartë gjyqtarësh joshqiptarë të Kosovës (Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica, Gjykata Komunale dhe Gjykata për Kundërvajtje në Leposavić/Leposaviq dhe Gjykata Komunale dhe Gjykata për Kundërvajtje në Zubin Potok) për shkak të mos-funksionimit të gjykatave atje.

Derisa këto shifra mund të tregojnë se gjyqtarët shqiptarë janë mesatarisht më të butë me të pandehurit joshqiptarë të Kosovës në gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje, OSBE-ja e thekson se shumë faktorë mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar të gjyqtarit në shpalljen e të pandehurit fajtor apo të pafajshëm. Veç kësaj, shkallë më e lartë e të pandehurve që i përkasin një grupi mund të rezultojë nga faktorët të jashtëm (p.sh. disa të pandehur mund të kenë avokatë më të mirë, ose prokurorët kanë sjell raste më të dobëta kundër disa të pandehurve).

Në mënyrë të ngjashme, dallimet e vërejtura ndërmjet të pandehurve serbë të Kosovës, romë, ashkali e egjiptian dhe boshnjakë të Kosovës nuk mund t'i atribuohen në mënyrë automatike njëanshmërisë së gjyqtarëve kundër një komuniteti të caktuar.

### 3. LLOJET E DËNIMIT

Treguesi i dytë, të cilin e ka analizuar OSBE-ja në krahasimin e dënimeve të shqiptuara të pandehurve të komuniteteve të ndryshme ka qenë lloji i dënimit.

Për të tri veprat e vlerësuara në këtë raport (armëmbajtja pa leje, vjedhja dhe prishja e rendit dhe qetësisë publike), ligji parasheh gjobitjen ose burgimin si dënime alternative. Gjyqtari vendos se cilin dënim ta shqiptoj duke u bazuar në rastin.

Gjyqtari vendos se çfarë dënimi të vendos nisur nga rrethanat e rastit specifik. Për më tepër, gjyqtari mund të vendos të jap dënim me kusht.<sup>16</sup> Dënimi me kusht jo vetëm që thelbësisht ka ndikim tjetër mbi të pandehurin se sa dënimi pa kusht (në praktikë, dënimi me kusht në shumicën e rasteve mbetet pa u ekzekutuar)<sup>17</sup> por teknikisht është dënim alternativ kundrejt dënimit efektiv.<sup>18</sup>

Prandaj, burgimi ose dënimi me burg me kusht konsiderohen dy lloje të ndryshme të dënimit. Për të njëjtën arsye, gjobitja me kusht shihet si lloj i veçantë i dënimit nga gjoba.

#### 3.1. Gjykatat e qarkut

**Tabela 9**

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Gjobë	67 (57%)	25 (24%)
Dënim me kusht	44 (37%)	68 (66%)
Burgim	7 (6%)	10 (10%)

<sup>16</sup> Dënimi me kusht është dënim alternativ ndaj burgimit (neni 41, Kodi i Përkohshëm Penal). Gjyqtari mund t'i shpall kryesit dënim me kusht për t'i dhënë qortimin, i cili e arrin qëllimin e dënimit përmes shqiptimit të dënimit pa ekzekutimin e të njëjtit (neni 42, Kodi i Përkohshëm Penal, neni 42).

<sup>17</sup> Megjithatë, dënimi me kusht mund të kthehet në dënim efektiv, nëse i pandehuri kryen ndonjë veprë tjetër brenda periudhës së parashikuar kohore (shih nenin 45, Kodi i Përkohshëm Penal).

<sup>18</sup> Shih nenin 41, Kodi i Përkohshëm Penal.

Siç është përshkruar në Tabelën 9, në rastet e armëmbajtjes pa leje (gjykatat e qarkut), të dy grupeve në më shumë se 90% të rasteve iu është shqiptuar gjobë ose dënim burgimi me kusht. Gjykatat kanë shqiptuar dënime efektive me burgim në vetëm 5.9% të rasteve që përfshijnë të pandehur shqiptarë të Kosovës dhe në 9.7% të rasteve që përfshijnë të pandehur joshqiptarë të Kosovës.

Të pandehurve shqiptarë të Kosovës iu është dhënë gjobë (57%) shumë më shpesh se sa që iu është shqiptuar dënim me kusht (37%). E kundërta, vlen për të pandehurit joshqiptarë të Kosovës, të cilëve iu është shqiptuar dënim me kusht në 66% të rasteve dhe gjobë në vetëm 24%.

**Tabela 10**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
Gjobë	3 (23.1%)	6 (60.0%)	15 (20.5%)	67 (56.8%)
Dënim me kusht	9 (69.2%)	4 (40.0%)	49 (67.1%)	44 (37.3%)
Burgim	1 (7.7%)	0 (0.0%)	9 (12.3%)	7 (5.9%)

Ndarja sipas përkatësisë etnike të të pandehurve në Tabelën 10 tregon disa dallime sa i përket dënimeve ndërmjet komuniteteve në gjykatat e qarkut. Të pandehurve romë, ashkali ose egjiptianë të Kosovës dhe shqiptarë të Kosovës iu është dhënë gjobë shumë më shpesh (57-60%) se sa të pandehurve serbë të Kosovës dhe boshnjakë të Kosovës (21-23%).

Të pandehurve boshnjakë të Kosovës dhe serbë të Kosovës iu është shqiptuar dënim me burgim (burgim dhe dënim me kusht) shumë më shpesh (77-79%) se të pandehurve shqiptarë të Kosovës dhe romë, ashkali dhe egjiptianë (40-43%).

Vlen të ceket se të pandehurve romë, ashkali dhe egjiptianë nuk iu është shqiptuar burgimi si dënim në asnjërin prej rasteve të vrojtuar.

### 3.2. Gjykatat komunale

**Tabela 11**

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Gjobë me kusht	11 (5%)	10 (17%)
Gjobë	150 (65%)	33 (55%)
Dënim me kusht	45 (20%)	9 (15%)
Burgim	24 (10%)	8 (13%)

Siç është pasqyruar në Tabelën 11, rastet në gjykatat komunale tregojnë dominim të dënimeve monetare (gjobë dhe gjobë me kusht), të cilat dënime iu kanë shqiptuar më shumë se gjysmës së të gjitha rasteve si për shqiptarët e Kosovës ashtu edhe për joshqiptarët e Kosovës (respektivisht 65% dhe 55%).

Shembulli relativisht i vogël i rasteve që përfshin joshqiptarët e Kosovës gjithashtu tregon përdorim më të madh të gjobave me kusht se sa në rastet që përfshijnë shqiptarë të Kosovës (17% kundrejt 5%).

Dënimet tjera (dënimi me kusht dhe burgimi) janë shqiptuar në përqindje të ngjashme të rasteve (15-20% dhe respektivisht 10-13%).

**Tabela 12**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
Gjobë me kusht	10 (48%)	0 (0%)	0 (0%)	11 (5%)
Gjobë	5 (24%)	4 (44%)	22 (79%)	150 (65%)
Dënim me kusht	4 (19%)	2 (22%)	3 (11%)	45 (20%)
Burgim	2 (9%)	3 (33%)	3 (11%)	24 (10%)

Bazuar në sasinë e kufizuar të të dhënave në dispozicion, ndarja e përkatësisë etnike të të pandehurve në Tabelën 12 tregon që në gjykatat komunale, boshnjakëve të Kosovës më së shpeshti iu është shqiptuar gjobë me kusht (48%),<sup>19</sup> përdërisa komuniteteve tjera më së shpeshti iu është shqiptuar gjobë me përqindje që radhiten prej 45% deri në 78%.

Të gjitha komuniteteve iu është shqiptuar shkallë e krahasueshme e dënimeve me kusht (11% deri në 22%). Burgimi efektiv ka qenë një dënim jo i zakonshëm për të gjitha grupet (9% deri në 11%) përveç për romët, ashkallitë dhe egjiptianët (33%).

### 3.3. Gjykatat për kundërvajtje

**Tabela 13**

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Gjobë	212 (73%)	100 (87%)
Burgim	78 (27%)	15 (13%)

Në rastet e ekzaminuara nëpër gjykatat për kundërvajtje siç janë treguar në Tabelën 13 gjoba ka qenë lloj primar i dënimit si për të pandehurit shqiptarë të Kosovës (73%) ashtu edhe për të pandehurit joshqiptarë të Kosovës (87%).

Të dhënat gjithashtu tregojnë se numri shqiptarëve të Kosovës që kanë marrë gjobë ka qenë përafërsisht dy herë më i lartë në krahasim me atë të joshqiptarëve të Kosovës (27% vs. 13%).

<sup>19</sup> Të gjitha dhjetë rastet në gjykatat komunale, ku boshnjakëve të Kosovës iu është shqiptuar dënim me kusht, kanë ndodhur në rajonin e Pejës.

**Tabela 14**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
gjobë	8 (73%)	24 (83%)	65 (90%)	212 (73%)
burgim	3 (27%)	5 (17%)	7 (10%)	78 (27%)

Të dhënat sipas përkatësisë etnike në Tabelën 14 tregojnë se në përgjithësi nuk ka dallime të mëdha në llojin e dënimeve të shqiptuara ndaj të pandehurve jo-shqiptarë të Kosovës në gjykatat për kundërvajtje. Gjoha ka qenë dënimi më i shpeshtë për të gjitha grupet (73% deri në 90%). Megjithatë serbët e Kosovës ishin dënuar me burg afërsisht për një të tretën shkallë sesa shqiptarët dhe boshnjakët e Kosovës (10% vs. 27%)

### 3.4. Analiza

Të dhënat nuk janë përfundimtare në asnjërin nga tri gjykatat në lidhje me atë se a marrin për afërsisht të pandehurit e komuniteteve të ndryshme lloje të dënimeve më të favorshme . Ndonëse dallimet ekzistojnë mes komuniteteve, këto dallime nuk janë në mënyrë konsistente në favor apo në dëm të një grupi të veçantë.

Shumë faktorë mund të ndikojnë në vendimin e gjyqtarit për të caktuar një lloj dënimi se sa një tjetër. Vendimi varet nga rrethanat e rastit (p.sh vlera e sendit të vjedhur, sasia dhe lloji i armëve të poseduara, shkalla e përgjegjësisë së të akuzuarit, dhe dosja e tij/saj penale.<sup>20</sup> Po ashtu mund të ndikohet edhe nga faktorë tjerë siç janë cilësia e përfaqësimit ligjor apo fuqia e rastit të prokurorisë. Andaj, nga këndvështrimi i faktorëve të tjerë të mundshëm ndërmjetësues, është e vështirë të vlerësohet se a ka ndikuar përkatësia etnike e të pandehurit në llojin e dënimit të caktuar, në rastet e shqyrtuara nga OSBE.

Veç kësaj nuk është e lehtë që të klasifikohen llojet e dënimeve të ndryshme sipas peshës që kanë për të parë nëse grupe specifike të të pandehurve marrin dënime më pak të favorshme. Përderisa dënimi me kusht është pa dyshim dënimi më i butë i paraparë me ligj, ndërsa burgosja dënimi më i rëndë, është e kontestueshme nëse dënimi me kusht është dënim më i rëndë sesa gjobitja. I pandehuri me kushte të rënda ekonomike mund të konsiderojë se dënimi me kusht është sanksion më i lehtë sesa gjobitja, ndërkohë që një person me gjendje të mirë ekonomike më me ëndje do të paguante gjobën sesa të rrezikonte<sup>21</sup> të burgoset.

Po edhe nëse merren në konsideratë dy të pandehur me kushte të njëjta ekonomike nuk mund të përcaktohet lehtë nëse dënimi me burgim me kusht është dënim më i rëndë sesa gjobitja. Disa mund të mendojnë që dënimi me kusht ( i cili ka gjasa të mos ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepra tjera brenda periudhës së përcaktuar kohore)<sup>22</sup> mund të jetë sanksion më i butë sesa humbja efektive financiare.

<sup>20</sup> Shiko Neni 64(1), Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>21</sup> Pezullimi i dënimit mund të revokohet në bazë të disa kushteve (shiko nenet 45-47, Kodi i Përkohshëm Penal).

<sup>22</sup> Shiko Nenet 42 dhe ato pasuese në Kodin e Përkohshëm Penal, që parashohin kushtet për shqiptimin (dhe revokimin) e dënimeve me kusht.

Për të përmbyllur, përderisa të dhënat mbi llojin e dënimeve tregojnë në ekzistimin e disa dallimeve mes të pandehurve të komuniteteve të ndryshme, OSBE-ja nuk mund të konkludojë që një grup i veçantë ka marrë dënim më të butë.

#### 4. DËNIMI MESATAR

Një indikator i fundit që ka analizuar OSBE-ja gjatë krahasimit të dënimeve të shqiptuara ndaj të pandehurve të komuniteteve të ndryshme është mesatarja e masës e dënimit.

Për shumicën e veprave, Kodi i përkohshëm penal përcakton minimumin dhe maksimumin ligjor. Gjyqtari ka liri të veprimit të shqiptojë dënimin brenda këtyre kufijve. Shumë faktorë mund të ndikojnë në masën e dënimit, siç janë sjellja e mëhershme dhe rrethanat personale të kryesit të veprës, rrethanat dhe motivet e të pandehurit.<sup>23</sup>

Natyrisht që kalkulimi i dënimit nuk është thjeshtë ushtrim matematikor. Shqiptimi i dënimit është proces kompleks, gjatë të cilit është vështirë të veçohet një variabël (njëanshmëria e mundshme e gjyqtarëve kundër/pro grupit etnik) në lartësinë përfundimtare të dënimit nga faktorë të tjerë. Prandaj, nuk mund të nxjerrën dëshmi të drejtpërdrejta të njëanshmërisë përmes analizimit të mesatareve të ndryshme të dënimeve që marrin të pandehurit për shkelje të dispozitave të njëjta ligjore. Të pandehurit e një grupi, gjersa bëjnë shkelje të të njëjtave dispozita ligjore, mund të shkaktojnë mesatarisht vepra më të lehta e (p.sh. vjedhja e ushqimit kundrejt vjedhjes së stolive të çmuara), të jenë kryes për herë të parë kundrejt kryesve recidivist, kanë pasur sjellje më korrekte pas kryerjes së veprës përfshirë edhe gjatë gjyqimit.<sup>24</sup>

##### 4.1. Gjykatat e qarkut

Tabela 15

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Gjobë	<b>398 Euro</b> (67 raste)	<b>333 Euro</b> (25 raste)
Dënim me kusht	<b>5.4 muaj</b> (44 raste)	<b>5.4 muaj</b> (68 raste)
Burgimi	<b>3.1 muaj</b> (7 raste)	<b>5.6 muaj</b> (10 raste)

Të dhënat e mbledhura në gjykatat e qarkut në Tabelën 15 tregojnë që të pandehurit joshqiptarë të Kosovës kanë marrë dënime mesatarisht identike të burgimit me kusht si të pandehurit shqiptarë të Kosovës (5.4 muaj). Gjobat mesatare janë po ashtu shumë të ngjashme (398 vs. 333 Euro) duke marrë parasysh maksimumin e lejuar me ligj.<sup>25</sup>

<sup>23</sup> Shiko Nenin 64(1), Kodi i përkohshëm penal. Në përcaktimin e gjobitjes gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen ekonomike të kryesit të veprës. Kjo ka të bëjë me pagën, asetet apo obligimet tjera (neni 64(3), Kodi i përkohshëm penal).

<sup>24</sup> Neni 64 i Kodit të Përkohshëm Penal detajon disa rrethana të cila gjyqtari mund t'i merr parasysh kur cakton peshën e dënimit.

<sup>25</sup> Për veprën penale "Posedim, Kontroll dhe Përdorim i Paautorizuar i Armëve sipas nenit 328 (2) të Kodit të Përkohshëm Penal, gjykata mund të vendos gjobë e cila sillet prej 50 deri në 7.500 Euro.

Megjithatë, të pandehurit joshqiptarë të Kosovës kanë pranuar nivel dukshëm më të lartë të dënimit efektiv me burg sesa të pandehurit shqiptarë të Kosovës (5.6 kundrejt 3.1 muaj).

**Tabela 16**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
Gjobë	<b>325 Euro</b> (3 raste)	<b>350 Euro</b> (6 raste)	<b>297 Euro</b> (15 raste)	<b>398 Euro</b> (67 raste)
Dënim me kusht (muaj)	<b>6.2 muaj</b> (9 raste)	<b>6.3 muaj</b> (4 raste)	<b>5.0 muaj</b> (48 raste)	<b>5.4 muaj</b> (44 raste)
Burgim (muaj)	jo aplikueshme (j/a)	jo e aplikueshme (j/a)	<b>4.2 muaj</b> (9 raste)	<b>3.1 muaj</b> (7 raste)

Tabela 16 tregon gjoba mesatare të krahasueshme për të gjitha grupet. Serbët e Kosovës kanë marrë mesatarisht gjobën më të ulët (297 Euro) ndërsa shqiptarët e Kosovës më të lartën (398 Euro).

Tabela 16 tregon se dënimet me burgim me kusht ishin paksa më të larta për boshnjakët e Kosovës dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët (6.2 dhe respektivisht 6.3 muaj) sesa për serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës (5.0 dhe respektivisht 5.4 muaj).

Veç kësaj, të pandehurit serbë të Kosovës kanë marrë masa paksa më të larta të burgosjeve sesa të pandehurit shqiptarë të Kosovës (4.2 vs. 3.1 muaj). Asnjë personi rom, ashkali, apo egjiptian nuk iu është shqiptuar ndonjë burgim në rastet e shqyrtuara nga OSBE-ja. Përderisa ishte një rast dënimi me burgim (18 muaj) për një të pandehur boshnjak të Kosovës, kjo është hequr nga tabela sepse do të jepte një përfaqësim joadekuat të ‘mesatares’ së burgimit.

## 4.2. Gjykatat komunale

**Tabela 17**

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Gjoha me kusht	<b>319 Euro</b> (11 raste)	<b>787 Euro</b> (10 raste)
Gjobë	<b>247 Euro</b> (150 raste)	<b>240 Euro</b> (33 raste)
Dënim burgimi me kusht	<b>3.0 muaj</b> (45 raste)	<b>3.7 muaj</b> (9 raste)
Burgim	<b>3.5 muaj</b> (24 raste)	<b>4.1 muaj</b> (8 raste)

Siç pasqyrohet në Tabelën 17 të dhënat për dënimet monetare në gjykatat komunale tregojnë që të pandehurit joshqiptarë të Kosovës kanë marrë shumë më gjobitje me kusht më të larta (787 Euro) sesa shqiptarët e Kosovës (319 Euro). Por ky observim është i bazuar mbi një numër relativisht të vogël të rasteve (11 të

pandehur të involvuar shqiptarë të Kosovës dhe 10 të pandehur joshqiptarë të Kosovës).<sup>26</sup>

Mesatarja e gjobave megjithatë, ishte paksa më e lartë për shqiptarët e Kosovës (247 Euro) sesa për joshqiptarët e Kosovës (240 Euro).

Tabela 17 gjithashtu tregon se të pandehurve joshqiptarë të Kosovës u janë shqiptuar dënime paksa më të larta të burgimit (3.7 vs. 3.0 muaj) dhe dënime burgimi me kusht (4.1 vs. 3.5 muaj) sesa të pandehurve shqiptarë të Kosovës.

**Tabela 18**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
Gjohitje me kusht	<b>787.5 Euro</b> (10 raste)	j/a	j/a	<b>319.5 Euro</b> (11 raste)
Gjohitje	<b>192 Euro</b> (5 raste)	<b>212 Euro</b> (4 raste)	<b>255.0 Euro</b> (22 raste)	<b>247.5 Euro</b> (150 raste)
Burgim me kusht	<b>4.3 muaj</b> (4 raste)	<b>3.0 muaj</b> (2 raste)	<b>3.3 muaj</b> (3 raste)	<b>3.0 muaj</b> (45 raste)
Burgimi	<b>0.8 muaj</b> (2 raste)	<b>4.3 muaj</b> (3 raste)	<b>6.0 muaj</b> (3 raste)	<b>3.5 muaj</b> (24 raste)

Tabela 18 tregon që boshnjakët marrin më shumë gjohitje me kusht sesa të pandehurit shqiptar. Në asnjë nga rastet e ekzaminuara të pandehurit serbë, romë, ashkali dhe egjiptianë kanë marrë gjohitje me kusht..

Siç shihet në Tabelën 18 të pandehurit boshnjakë të Kosovës gjithashtu kanë marrë më shumë dënime burgimi me kusht (4.3 muaj) sesa të pandehurit nga grupet tjera (3.0 deri në 3.3 muaj). Megjithatë, boshnjakët e Kosovës kanë marrë dënime me burg me të ulëtën (0.8 muaj). Të pandehurit serbë të Kosovës kanë marrë mesatarisht masa më të gjata burgimi (6 muaj) përderisa shqiptarët e Kosovës dhe romët, ashkalitë e egjiptianët radhiten ndërmjet 3.5 dhe 4.3 muaj.

### 4.3. Gjykatat për kundërvajtje

**Tabela 19**

	Shqiptarë të Kosovës	Joshqiptarë të Kosovës
Gjohitja	<b>134Euro</b> (212 raste)	<b>130 Euro</b> (100 raste)
Burgosja	<b>24 ditë</b> (78 raste)	<b>22 ditë</b> (15 raste)

Tabela 19 që përmbledh të dhënat e mbledhura në gjykatat për kundërvajtje tregon që të pandehurit shqiptarë të Kosovës dhe joshqiptarë të Kosovës kanë mesatare të ngjashme të dënimeve për prishje të rendit dhe qetësisë publike. Shqiptarët e Kosovës kanë marrë pak më shumë dënime me burgim (24.1 vs. 21.7 ditë) dhe gjoba paksa më të larta (134 vs. 130 Euro) sesa të pandehurit joshqiptarë të Kosovës.

<sup>26</sup> Veç kësaj siç tregohet në Tabelën 18 më poshtë, të gjithë të pandehurit joshqiptarë ishin boshnjakë të Kosovës.



**Tabela 20**

	Boshnjakë të Kosovës	Romë, ashkali dhe egjiptianë	Serbë të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës
Gjykitja	<b>130 Euro</b> (8 raste)	<b>122 Euro</b> (24 raste)	<b>136 Euro</b> (65 raste)	<b>134 Euro</b> (212 raste)
Burgosja	<b>15 ditë</b> (3 raste)	<b>19 raste</b> (5 raste)	<b>26 ditë</b> (7 raste)	<b>24 ditë</b> (78 raste)

Ndarja sipas përkatësisë etnike të të pandehurve në Tabelën 20 tregon që mesatarisht në gjykatat për kundërvajtje të gjitha grupet kanë marrë gjoba pothuajse identike (122 deri në 136 Euro).

Tabela 20 gjithashtu tregon se të pandehurve serbë të Kosovës dhe atyre shqiptarë të Kosovës mesatarisht u janë shqiptuar pak më shumë dënime me burgim (24 deri në 26 ditë) sesa të pandehurve boshnjakë të Kosovës dhe të pandehurve romë ashkali dhe egjiptianët (15-19 ditë).

#### 4.4. Analizat

Të dhënat nga të tri gjykatat sugjerojnë se dënimi mesatar i shqiptuar ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe joshqiptarëve të Kosovës nuk ka ndonjë dallim thelbësor. Ngjashëm të dhënat tregojnë se dënime mesatarisht të ngjashme ndërmjet të të pandehurve serbë të Kosovës, romë, ashkali, egjiptianë dhe boshnjakë të Kosovës.

Megjithatë ka dy përjashtime që vlen të përmenden: burgosjet në gjykatat e qarkut dhe gjykitjet me kusht në gjykatat komunale. Mesatarisht, masat e këtyre dënimeve janë dy herë më të mëdha për joshqiptarët e Kosovës sesa për shqiptarët e Kosovës.

Është vështirë të sqarohet ky dallim, meqë indikatorë tjerë në gjykatat e njëjta janë shumë të ngjashëm për shqiptarët dhe joshqiptarët të Kosovës. Vlen të përmendet se, përderisa gjykitjet e shqiptuara me kusht në gjykatat komunale janë më të shpeshta ndaj joshqiptarëve të Kosovës, mesatarja e gjykitjeve është më e vogël. Njësoj qëndron puna edhe me gjykatat e qarkut ku masa e burgimit është më e madhe për joshqiptarët e Kosovës dhe dënimet me burgim me kusht janë pothuajse identike si për shqiptarët e Kosovës ashtu edhe për joshqiptarët e Kosovës.

Në përgjithësi rezultatet janë të përziera, në atë se asnjë grup nuk merr në mënyrë konstante dënime më të larta apo më të ulëta andaj nuk qon në ndonjë përfundim të prerë.

## 5. PËRKATËSIA E NJËJTË KUNDREJT PËRKATËSISË SË NDRYSHME ETNIKE TË GJYQTARËVE

Për rastet e gjykatave të qarkut,<sup>27</sup> OSBE-ja gjithashtu ka krahasuar rastet kur i pandehuri dhe gjyqtari kanë përkatësi të njëjtë etnike<sup>28</sup> me rastet me përkatësi të ndryshme mes tyre.<sup>29</sup>

<sup>27</sup> Siç është përmendur në futnotën 13, nuk ka pasur të dhëna të mjaftueshme për gjykatat komunale dhe gjykata për kundërvajtje ku shumica dërmuese e rasteve (ndërmjet 95% dhe 99%) përfshinin gjyqtarë shqiptarë.

<sup>28</sup> P.sh kur gjyqtari dhe i pandehuri janë shqiptarë të Kosovës apo të dy janë serbë të Kosovës.

**Tabela 21**

	Ku gjyqtari ka përkatësi të njëjtë etnike	Ku gjyqtari ka përkatësi të ndryshme etnike
Numri i rasteve	134 (57%)	102 (43%)

### 5.1 Shkalla e shfajësimit/dënimit

**Tabela 22**

	Ku gjyqtari ka përkatësi të njëjtë etnike	Ku gjyqtari ka përkatësi të ndryshme etnike
Fajtor	126 (94%)	95 (93%)
Jo fajtor	8 (6%)	7 (7%)

Të dhënat tregojnë shkalla identike të dënimeve/shfajësimeve për të dy grupet

### 5.2. Lloji i dënimit

**Tabela 23**

	Ku gjyqtari ka përkatësi të njëjtë etnike	Ku gjyqtari ka përkatësi të ndryshme etnike
Gjoba	68 (54%)	24 (24%)
Burgimi me kusht	54 (43%)	58 (57%)
Burgim	4 (3%)	13 (13%)

Të dhënat tregojnë se ku i pandehuri dhe gjyqtari i përkisnin etnive të ndryshme, gjyqtarët vendosnin dënim burgimi me kusht më shumë se sa gjobitje (57% vs. 24%). Kur gjyqtari dhe i pandehuri kanë etni të njëjte, gjobitja ishte dënimi më i zakonshëm (54%) dhe dënimet me burg me kusht ishin shqiptuar në vetëm 24% të rasteve.

Vlen të ceket se burgimi efektiv ishte vendosur më se katër herë më shpesh kur gjyqtari dhe i pandehuri i përkisnin etnive të ndryshme (13% vs.3%).

### 5.3 Dënimi mesatar

**Tabela 24**

	Ku gjyqtari ka përkatësi të njëjtë etnike	Ku gjyqtari ka përkatësi të ndryshme etnike
--	---	---

<sup>29</sup> Për shembull, gjyqtari është shqiptar i Kosovës ndërsa i pandehuri është serb i Kosovës, apo gjyqtari është serb i Kosovës dhe i pandehuri është rom i Kosovës.

Gjorbitjet	377 Euro	389 Euro
Dënim me kusht	4.6 muaj	6.2 muaj
Burgosja	4.0 muaj	4.8 muaj

Të dhënat tregojnë një trend konstant të rritjes së dënimeve më të mëdha në rastet kur gjyqtari dhe i pandehuri i takojnë përkatësive të ndryshme etnike. Dallimi është modest sa i përket gjorbitjeve (mesatarisht 3% më i lartë), por më i madh për të dy llojet e burgimeve (mesatarisht, 20% më e lartë) dhe për dënimet me kusht (mesatarisht, 35% më e lartë).


Mesatarja më e lartë e observuar e dënimeve në rastet e gjykatave të qarkut mund të sugjerojë që gjyqtarit në gjykatat e qarkut shqiptojnë dënime më të rënda kur gjyqtari dhe i pandehuri i takojnë grupeve të ndryshme etnike. Sidoqoftë, faktet e ndryshme në këto raste mund të luajnë rol në dallimet e dënimeve.

## 6. PËRFUNDIM

Një pasqyrim i të dhënave të nxjerra nga më se 1,000 lëndë në gjykatat e Kosovës tregon se nuk ka ndonjë dallim substancial në dënimet dhe rezultatit e gjykimeve ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe joshqiptarëve të Kosovës ose në mesin e këtyre të fundit. Veç kësaj, dallimet e pakta të vrojtuar nuk kanë favorizuar ndonjë grup apo komunitet të veçantë. Në çfarëdo rasti dallimet e vrojtuar ndërmjet grupeve nuk dëshmojnë domosdoshmërisht njëanshmërinë në favor apo në dëm të një grupi specifik. Fakte të veçanta apo rrethanat lehtësuese ose rënduese të rastit mund të sqarojnë dallimet.

Vlen të përmendet se OSBE-ja ka vërejtur se në rastet gjykatave të qarkut ku i pandehuri dhe gjyqtari kanë përkatësi të njëjta etnike, të pandehurit ishin burgosur më rrallë dhe kanë marrë dënime paksa më të lehta sesa në rastet ku i pandehuri dhe gjyqtari kishin përkatësi të ndryshme etnike.

Meqë ky ishte një studim preliminar që nuk ka pasur nën kontroll të të gjithë faktorët gjë që do të mund të ndikonin në dënim, është me rëndësi që të merren parasysh kufizimet rreth këtij studimi. Ky raport ofron vetëm pasqyrë fillestare e cila do të mund të shërbente që kjo temë të hulumtohet dhe analizohet më tej.



Kjo hartë nuk paraqet dokument zyrtar dhe është ofruar vetëm për referim.